

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE "HORIZONT" sh.p.k



Nga Beniamin RUSI, i biri i Samiut dhe i Sabries, lindur ne Durres, me 22.01.1954
dhe banues ne Tirane, ne Rrugen "Komuna e Parisit" Pall.6/2/30, me pasaporte AZ
Nr.465362.

Themelon nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar, me te drejta shqiptare, e quajtur
"HORIZONT" Sh.p.k., qe me poshte do te quhet shoqeri.

Shoqeria do te kete terma juridike, me perjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i saj do te
rregullohet nga normat e parashikuara ne kete akt, nga Statuti bashkalidhur dhe nga
dispozitat ligjore ne fuqi lidhur me kete ceshtje.

1- Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

- Veprimtari per drejtim punimesh per supervizione e kolaudime ne fushen e
ndertimeve civile, industriale dhe publike.
- veprimtari ne projektimin dhe zbatimin e ndertimeve ne punimet e ndertimeve
civile, industriale dhe publike ne pergjithesi si dhe ne punime rrugore, urave,
tuneleve, punimet hidroteknike, nyje e impiante prodhimi materiale ndertimi
etj.
- veprimtari export- importi, ne furnizimin me lende te para dhe paisje per
ndertime si dhe makineri dhe paisje per prodhimin e tyre.

- 2- Emri i shoqerise eshte " HORIZONT " sh.p.k. me seli ne Tirane ne rrugen
"komuna e Parisit" Pall.6/2/30
- 3- Kohezgjata e shoqerise eshte e pakufizuar
- 4- Kapitali i hestor i shoqerise eshte 100.000 leke, i derdhur teresisht nga ortaku i
vetem, themeluesi i kesaj shoqerie.
- 5- Shoqeria do te administrohet nga nje keshill administrativ, antaret e te cilil
zgjidhen nga ortaku i vetem, me mandate te perseritura.
- 6- Shoqeria do te organizohet edhe me norma te parashikuara ne statut, te cilat pasi
lexohen, nenshkuhen

Akti u redaktua ne tre kopje autentike.

THE NYELUESI

BENIAMIN RUSI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Benjamin Rusi'.

STATUTI

I SHOQERISE "HORIZONT" sh.p.k

Pala nenshkruese: Beniamin RUSI, i biri i Samiut dhe i Sabries lindur ne Durres me 22.01.1954 dhe banues ne Tirane ne rrugen "Komuna Parisit" P6. Shk. 3. Ap30. me pasaporte A.Z Nr. 465362, Shtetas Shqiptar madhor me zotesi te plota juridike per te vepruar, i cili ka hartuar Aktin e Themelimit dhe Statutin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

FORMA

Nga nenshkruesi i ketij Akti Themelor eshte krijuar nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne dispozitat e ketij statuti.

Neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE

Emri i Shoqerise eshte "HORIZONT" sh.p.k. shoqeri me personalitet te kufizuar.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE DO TE JETE:

- Veprimtari per drejtim punimesh per supervizione e kolaudime ne fushen e ndertimeve civile, industriale dhe publike.
- veprimtari ne projektimin dhe zbatimin e ndertimeve ne punimet e ndertimeve civile, industriale dhe publike ne per gjithese si dhe ne punime rrugore, urave, tuneleve, punimet hidroteknike, nyje e impiante prodhimi materiale ndertimi etj.
- veprimtari export-importi, ne furnizimin me lende te para dhe paisje per ndertime si dhe makineri e paisje per prodhimin e tyre.

Shoqeria, gjithashtu, ne veprimtarine e saj kryesore dhe ndihmese, do te kryeje aktivite te tjera qe lidhen me objektivin kryesor te veprimtarise se shoqerise dhe qe duhet te jene te pajtueshme me interesat e saj.

Neni 4

Selia e shoqerise eshte me qender ne Tirane, Rr."K.Parisit" P 6, Shk.2, Ap.30.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise "HORIZONT" sh.p.k.. eshte e pakufizuar dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.

K R E U II

KAPITALI THEMELOR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELOR

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital eshte teresisht i formuar nga administratori i shoqerise dhe eshte i depozituar ne banke. Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj sipas vendimit qe do te marre organizuesi i shoqerise.

Neni 7

Pjeset e Kapitalit Themelor jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve nese kane pjese te te tyre nga ky kapital, gjithashtu ato jane lirisht te transferueshem ne rast ndarje pasurore ne mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.

Formimi dhe Transferimi i pjesave te Kapitalit Themelor duhet te vertetohet me akt notarial.

K R E U III

Neni 8

Ortaku eshte perjegjes per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij. Shoqeria administrohet nga administratori i pergjithshem si dhe nga nje keshill administrative. Keshilli administrative dhe antaret e tij zgjidhen nga krijuesi i shoqerise.

Neni 9

Numri i punonjesve, paga dhe detyrat e secilit caktohen nga administratori ishoqerise.

Me lidhjen e kontrates, punonjesit nuk kane te drejte te largohen nga puna, por vetem me perfundimin e afatit te kontrates.

Per shkelje te renda disiplinore, punonjesit largohen nga puna vetem nga ortaku I vetem.

Neni 10

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Administratori i per gjithshem i shoqerise vendos per ceshjtje te tilla si: emerim apo revokim te administratoreve, te eksperteve kontabel te autorizuar, te likuidatoreve, aprovin e raporteve te administrimit, te bilanceve vjetore, ndryshimet qe mund te behen ne statut, shtimin apo pakesimin e kapitalit te shoqerise, transferimin e nje pjese te kapitalit tek te trete, shtytja e kohezgjatja e shoqerise apo vendosja per likujdimin e saj, nderrimin e formes se shoqerise etj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave qe perben ky Statut, Akti i Themelimit si dhe ato te legjislacionit ne fuqi. Ajo fiton zotesi per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te regjistrimit si subject privat prane zyrave te rajonit perkates te tatum taksave. Shoqeria ka vulen e saj me permajtje ne gjuhen shqipe si dhe llogari likujduese ne Banke.

Neni 12

Shoqeria vepron ne regjin e prones private, parimeve te ekonomise se tregut, me qellim kryesor fitimin. Ajo posedon pasurine e saj dhe ka te drejten e perdorimit te kesaj pasurie, te kredive te ndryshme dhe te kontraktive sipas qellimeve dhe objektivave te veprimtarise qe ka parashikuar te zbatoje. Shoqeria gezon te drejten te mbroje pasurine e saj private sipas Kushtetutes dhe Ligeve Shqiptare.

Shoqeria merr persiper te drejta dhe detyrite kontraktore dhe jashte kontraktore Brenda kapitalit themelor te saj. Pronari i shoqerise nuk per gjigjet per keto detyrite me pasurine e tij te fituar me aktivite te tjera ekonomike jashtë kesaj shoqerie.

Neni 13

Shoqeria merr vendime ne zbatim te plete te ligjeve ne fuqi dhe te ketij Statuti, te cilat jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithe te punesarit ne kete shoqeri, sipas nevojave qe paraqiten per zbatim te shoqerise bazuar edhe ne rregulloren e brendshme te shoqerise.

Ajo puneson puntore dhe administratore te cilet qendrojne ne detyre deri sa revokohen nga shoqeria ose largohen vete me deshire me mbarimin e afatit per te cilin ka kontraktuar. Administratoret e emeruar i kane te gjitha kopetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te rastit kur keto kompetencia i jane caktuar shprehimisht ortakut te vetem. Ne kete rast shoqeria nuk merr persiper pasojet ndaj te treteve dhe administratori per gjigjet ne menyre individuale. Administratori i per gjithshem, si dhe ai i caktuar prej tij me akt delegimi te shkruar, eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise duke kryer cdo veprim qe e quan me interes te shoqerise si edhe duke perfaqsuar shoqerine prane cdo organi apo institucion si dhe ne organet gjyqesore.

K R E U IV

MAREDHENIET PER PUNESIM

Neni 14

Kriteret e per gjithshme te punesimit te personave te tjere, numri i tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e seciles shoqeri, percaktohen nga ortaku u vetem. Punesimi i personave ne shoqeri kryhet mbi bazen e kontratave individuale te punes te hartuar sipas Legjislacionit Shqiptar dhe qe firmoset nga punedhenesi dhe i punesuari.

Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimit shoqeror per te gjithe te punesuarit ne te, ndersa keta te fundit duhet ta pranojne kete statut.

Neni 15

PUNESIMI I PERSONAVE

Punesimi i personave kryhet mbi bazen e kontrollit te punes dhe te punesuarit ne shoqeri per gjigjen sipas ligjeve dhe sipas ketit Statuti.

Per mos zbatim te detyrave dhe per demet e shkaktuara shoqerise, administratoret mbajne per gjegjesi civile dhe penale ne kryerjen e detyrave te tyre. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjesë ne ndarjen e fitimit qe realizon shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike.

Neni 16

Aministratoret e emeruar ne shoqeri nuk marrin cilesine e ortakut dhe nuk lejohet te ushtrojne asnje aktivitet konkuries me ate, te cfaredo lloji qofte ne llogari te tij apo per te tjere. Per cdo shkelje ne kete drejtim administratori largohen nga shoqeria dhe per gjigjet per demet e shkaktuara asaj.

K R E U V

KONFIDENCIALITETI

Neni 17

Te punesuarve ne shoqeri ne shoqeri nuk u lejohet qe te ekspozojne, reklamojnë apo shpallin asnje pasuri tek personat e tjere si dhe dokumentacionin qe disponon shoqeria, kontratat, planet qe ajo ka ose do te lidhe per te ardhmen.

Neni 18

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjere qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te trete duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas saj fjalen sh.p.k si dhe emrin e administratorit.

Neni 19

Shoqeria do te konsideroje qendren e vet ne Tirane si shoqeri meme, e cila rast pas rasti do te hapet edhe ne filialet e tjera ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interesa ne permbushjen e qellimeve te saj.

KONTROLLI I BRENDSHEM

Neni 20

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me nje ose me shume ekspert kontabel te autorizuar.

Eksperti kontabel zbaton dhe kontrollon zbatimin e ligjshmerise se Statutit, garanton qe llogarite dhe inventaret vjetore te pasurise se shoqerise jane hartuar drejt dhe japos nje pasqyrim te sakte te realizueshem te operacioneve te vitit te kaluar finanziar, te gjendjes financiare te trashegimise se shoqerise ne vitin e fundit. Ai eshte perjegjes para shoqerise dhe para te treteve per pasojat qe rrjedhin nga faljet dhe nenvleresimet e tij ne ushtrimin e funksioneve dhe vleresimeve te dhena.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 21

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve dhe urdherave te vecante qe jep administratori i per gjithshem.

Ne fund te cdo periudhe vjetore, administratori i ngarkuar nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin ekonomik, fitimin, humbje, inventare e raporte perkatese sipas ligjeve, rregullave dhe dokumentacionit baze te miratuar. Bilanci kontabel miratohet nga administratori i per gjithshem brenda 31 marsit te vitit ne vazhdim.

Ne miratimin e bilancit kontabel vjetor shoqeria vendos per krijimin e fondeve te ndryshem te nevojshem si fondin e akumulimit, fondin reserve etj.

Per rezerva financiare caktohet 5% e fondit vjetor deri sa ky fond te arrije ne 10% te fondit themelor te shoqerise. Pas ketij nivelit kuota e rezervimit vjetor eshte e lire.

Neni 22

Te ardhurat neto pas vecimit te fondit si me siper dhe te shlyerjes se detyrimeve fiskale i mbisin per perdonim ortakut te vetem qe eshte edhe themeluesi i Statutit te shoqerise.

K R E U VI

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 23

Shoqeria konsiderohet e prishur ne rastet kur shpallet si e tille nga administratori i per gjithshem si dhe kur nuk permbush kerkesat ne ligj per egzistencen e saj.

Neni 24

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku u vetem cakton nje ose me shume likujdues, te cilet i paraqesin atij reportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit ortaku i vetem vendos per bilancin finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe te shlyerjes te pjeseve te kapitalit themeltar te kontribuesit perkates nese ka te tille, likujduesi ndan kapitalin per ortakun e vetem i cili ka investuar teresisht kapitalin e shoqerise.

Neni 25

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet plotesimeve nga ortaku i vetem. Ndryshimet dhe plotesimet behen me te njeften menyre me te cilin behet edhe vete nxjerra e ketij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Ky Statut u redaktua ne 3 kopje autentike dhe pasi lexohet dhe gjendet sipas vullnetit te ortakut te vetem nenshkruehet prej tij rregullisht.

ORTAKU I VETEM

Beniamin RUSI

BENIAMIN RUSI

